

Shënime për përkthimet e veprave të Ismail Kadaresë në Japoni

IURA Ichiro (Japoni)

Në vitin 1969 u përktheu romani *Qyteti i fundit* me autor Petro Marko, një nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë shqipe, në japonisht. Ky përkthim i parë (jo vetëm përkthimi i parë të veprës letrare shqipe në Japoni, por edhe përkthimi i parë drejt nga shqipja) u përgatit nga Naono Atsushi, profesori emeritus i gjuhës rumune të Universitetit të Tokios dhe u botua me dy vëllime, si një pjesë e serisë “Vepra të zgjedhura të letërsisë revolucionare në botë”, nën drejtimin e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Japonisë. Dhe qysh atëherë, në Japoni, asnjë vepër letrare shqipe s’është përkthyer, s’ka dalë në qarkullim, deri në fillimin e viteve ’90 (Si përjashtim, në vitet ’70 disa raporte e fjalime të Enver Hoxhës janë botuar nga fraksioni i vogël maoist, të ndarë nga PK e Japonisë, shumica e anëtarëve të cilit ishin në atë kohë hoxhaistë).

Në vitet ’70 -’80, për shkak të largësisë së madhe, jo vetëm gjeografike e historike por edhe politike e diplomatike, veprimtaritë kulturore-letrare e shkrimtarëve shqiptarë janë mbajtur jashtë vëmëndjes së medias japoneze, ndërkohë në fushën e shkencës shoqërore ka patur disa studiuës që kanë mbajtur kontakte të dobët, por të vazhdueshme me të dhënat e Shqipërisë dhe të shteteve të tjera të Ballkanit, veçanërisht lidhur me politikën e historinë pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë diskutimeve të tyre, janë përmendur vetëm emrat e shkrimtarëve të shquar (p.sh. Naim Frashëri, Petro Marko, Sabri Godo, Dritëro Agolli edhe Ismail Kadare) dhe disa tituj të veprave kryesore të tyre.

Gjithashtu në fushën e gjuhësisë (historike, krahasuese ose indoevropiane) ka ekzistuar disa studiuës që ishin të interesuar për të mësuar gjuhën shqipe pranë gjuhësh të tjera ballkanike. Ka mundësi se ka patur njerëzit që ishin të interesuar të përkthejnë ca tekste letrare nga gjuha shqipe origjinale. Mirëpo tashmë s’është e qartë se sa ka qenë njerëz të tillë në atë kohë. Këtu mund të tregoj vetëm një shembull se në librin e parë (dhe e vetëm deri tani) për gramatikën deskriptive e gjuhës shqipe në Japoni, të cilin e shkroi profesori Naono i lartpërmenduar në vitin 1989, përmbahen disa pjesë të cituara nga romani *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* si material leximi. Shkurt; në Japoni në ato vite veprimtaria letrare e Ismail Kadaresë ishte njohur në mënyrën e zhdrejtë, vetëm pjesërisht.

Përkthimet e veprave të kryesore të Kadaresë u botuan në japonisht, ose në përshtatje me gjendjet atëherëshme në Shqipëri ose vetëm rastësisht, për tri vite me radhë në gjysmën e parë të viteve ’90. Në vitin 1994 *Pallati i ëndrrave* u botua nga shtëpia botuese Sogensha, *Kush e solli Doruntinën* nga shtëpia botuese Hakusuisha, pothuaj njëkohësisht. Nga Hakusuisha u botua *Prilli i thyer* në vitin tjetër 1995. *Muzgu i perëndive të stepës* u botua më 1996 nga shtëpia botuese Chikuma Shobo.

Interesant është se shumica e këtyre veprave janë botuar nga Hakusuisha dhe Sogensha. Midis lexuesve japonezë këto të dyja shtëpi botuese janë shumë të njohura, jo vetëm me përkthimet e letërsisë së huaj (kryesisht evropiane), por edhe me botimet e novelave detektive edhe të atyre fantastiko-shkencore brenda dhe jashtë vendit (në Japoni, ndoshta nuk është e njohur në vendet e

tjera, por ka tradita njëshekullore e larmishme të novelave fiktive detektive, ka shumë shkrimtarë dhe kritikë vendasë në atë lloj letrar).

Nuk besoj, natyrisht, se vepra e Kadaresë u pranua si asgjë tjetër veç novelës detektive apo fantastiko-shkencore, por ma merr mendja se disa karakteristika dalluese në botën e veprës së tij, si misteriozitet (ngatërrimi i hipotezave midis personazheve lidhur me ngjarjet), absurditet (fati i pakundërshtueshëm që i qëllon sërish protagonistit), edhe shprehje iluzive e alegorike që na nënkupton ose ngjarje në vendin ku jetojmë ose atë në botën tjetër që gjendet diku larg ose u gjend dikur mbi rruzullin tokësor, e tërhoqën vëmendjen e botuesve e të lexuesve të cilëve u pëlqejnë edhe novelat fiktive e llojeve të lartpërmendura.

Përveç atyre botimeve, tregimi *Sjellësi i fatkeqësisë* është përmbajtur në një antologji të letërsisë moderne të huaj në vitin 1997, emri i cilës është “Frontiers of World Literature”, nga shtëpia botuese Iwanami, një nga shtëpitë botuese më të vjetra në Japoni. Ky fakt më duket simbolik se në ato vite Kadareja është vlerësuar në Japoni, pak a shumë, si faktor aktual në zhvillimin e letërsisë bashkëkohore e botës.

Siç e përmenda më lartë, nuk është e qartë se a vlerësimi i tillë është lartësuar duke sinkronizuar me ndryshimet politiko-shoqërore në Shqipërinë në atë periudhë. Por të gjitha këto botime janë shitur krejt gjatë viteve '90, s'janë ribotuar, s'ka dalë më në qarkullim deri tani (me vetëm një përjashtim, siç e përmend më poshtë). Fakti se ka ekzistuar përkthimi i Petro Markos rreth 30 vjet më parë, në atë kohë, ishte harruar krejt.

Më tepër, secili vepër është përkthyer në japonisht nga verzioni në gjuhën frënge (sidomos botimi i Fayard-it). Tashmë më bën përshtypje se këto nuk janë importuar si “letërsia shqipe” pikërisht, por si një komponent i “letërsisë së huaj” të interpretuar me gjuhën frënge. Megjithkëtë, ky rresht i botimeve e ka shkaktuar zhvillimin e interesit ndaj letërsisë dhe kulturës shqipe në Japoni.

Në fillimin e shekullit të ri, krijimtaria e Kadaresë ka zgjuar kureshtjen e dashamirëve të letërsisë së huaj në Japoni, veçanërisht që nga viti 2005 kur Kadareja e fitoi çmimin “Man Booker International”. Në vitin 2009, kur shkrimtari u nderua me çmimin spanjoll “Princi i Asturias” për Letërsinë, përkthimi i romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* doli në qarkullim. Ky, përkthimi i parë (dhe i vetëm deri tani) të veprës së tij që u përktheu drejt nga teksti shqip, u botua nga Shoraisha, shpëpia botuese e Kiotos, që është e njohur për botimet për letërsi, filozofi dhe shkencë shoqërore, si një vëllim i serisë të veprave të zgjedhura me emrin “Imagjinata e Evropës Lindore”, midis të cilave përmbahen edhe veprat nga Danilo Kish, Bohumil Hrabal, Milorad Paviq, Esterházy Péter, etj.

Më duhet të them se verzioni japonez i këtij romani monumental u botua tepër vonë, në krahasim me botimet e përkthimeve të tjera në Azi (në Kinë dhe në Korenë e Jugut, më 1992 dhe më 1994 respektivisht. Madje në Vietnam më 1972!). Mirëpo, gjatë këtyre viteve lexuesit japonezë kanë kuptuar gradualisht se ky shkrimtar i një vendi të panjohur (për japonezët) është vlerësuar lart në vendet e tjera, dhe se ka qenë sërish në mesin e të nominuarve për çmimin Nobel për Letërsi.

Në vitin 2012 *Pallati i ëndrrave* u ribotua për herë të parë me formatin e “librit të xhepit”. Ashtu si në vendet e tjera, edhe në Japoni shumica e novelave dhe tregimeve ribotohen në formatin “libër xhepi” që kushtojnë më të lira, favorizohen më shumë. Prandaj do të jetë më e lehtë që shumë lexuesit ta takojnë këtë roman në japonisht.

Këtu përmend edhe një episod; Tedi Papavrami, i cili ka përkthyer veprat e Kadaresë pas vdekjes së Jusuf Vrionit, është shumë i njohur nga karriera e tij si violinist në Japoni. Libri i tij autobiografik *Fugë për violinë* u përktheu në japonisht, “vetëm” tri vjet pas botimit origjinal në Francë. Shumica e lexuesve të librit të tij, duke u njohur me karrieren e tij si përkthyes, do të bëhen e afërt dhe e dashur me veprat letrare të Kadaresë të përkthyer në japonisht.

Ndryshe nga historia e marrëdhënieve shqiptaro-kineze, në të cilën kanë ekzistuar kontaktet, shkëmbimet e dendura midis intelektualëve (këtu më kujtohen shkrimtari dhe matematikani shqiptar Fatos Kongoli edhe albanologu dhe përkthyesi kinez Çen Ēn Bo), në Japoni, Shqipëria ka qenë një nga vendet më të painformuara e bllokut “sovjetik” në Evropën lindore (“juglindore” apo “mesdhetare” në terminologjinë gjeografike pas luftës së ftohtë). Prandaj, për fat të keq, nuk është formuar shtresa e intelektualëve të tillë (për sa u përket simpatizantëve të PPSH-së në Japoni, askush prej tyre nuk u shfaq në fushën e përkthimit të letërsisë).

Tashmë në mënyrë të ngadalshme, por për fat të mirë, pavarësisht edhe nga pikëpamja politiko-ideologjike edhe nga paragjykime dogmatike, lexuesit japonezë, të cilëve u pëlqen letërsia bashkëkohore evropiane, po gjejnë mundësi të shijojnë veprat e shkrimtarit të famshëm shqiptar.

Megjithëkëtë, mbetet akoma një hapësirë e zbrazët që ka nevojë të mbushet sa më shpejt. Veprat si romanet *Dimri i vetmisë së madhe* dhe *Koncert në fund të dimrit* që pasqyrojnë situatën e ndërlikuar politike të Shqipërisë në kohën e Luftës së Ftohtë, si diptiku *Vajza e Agamemnonit* dhe *Pasardhësi* gjithashtu, si dhe romani *Kronikë në gur*, përmes së cilit përshkruhet koha e luftës në qytetin e Gjirokastrës ku shkrimtari kaloi fëmijërinë e tij, akoma s’mund të lexohen në japonisht, ndonëse titujt e atyre romaneve janë mjaft të famshëm.

Duke lexuar romanet si këto, mund të shikohen qartë lokalja (apo rajonalja) dhe universalja në veprat e Kadaresë, që janë vlerësuar deri më sot ndërkombëtarisht. Por nuk është e lehtë që të realizohet botimi i këtyre veprave në gjuhën japoneze. Prandaj, që prej vitit 1997 kam hapur faqen personale të internetit <http://hb6.seikyoku.ne.jp/home/iura/perkthim.htm>, në të cilën mund ti lexojnë përkthimet e mia të romaneve të Kadaresë në japonisht, si *Dimri i vetmisë së madhe* (pjesa e parë dhe e dyta, deri në këtë moment), *Përbindëshi* dhe disa tregime dhe intervista, pranë veprave të shkrimtarëve të tjerë bashkëkohorë, si *Kalorësi lakuriq* nga Dritëro Agolli, *I humburi* nga Fatos Kongoli, *Net mëkatarësh* nga Ermir Nika etj. Unë, si një ndër përkthyesit të letërsisë shqipe, shpresoj se kjo përpjekje e vogël mund të kontribuojë për prezantimin e vlerës më të mirë dhe më përfaqësuese të kulturës dhe krijimtarisë letrare shqiptare në Japoni.